

# KONTRATË THEMELIMI

## I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### **“M&G GROUP” Sh.P.K.**

Sot me datë 17.08.2023, në Sarandë, me vullnetin tonë të lirë, ne të nënshkruarit:

- Ferdinand ISMAILI, i biri i Xheladin, i datëlindjes 21 Janar 1964, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.036574198 dhe numër personal G40121158Q me datë lëshimi 28/10/2020
- Pandeli DHIMA, i biri i Vasil, i datëlindjes 20 Shtator 1953, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.035410624 dhe numër personal F30920087R me datë lëshimi 24/12/2019
- Endrin LLANAJ, i biri i Ilirjan, i datëlindjes 18 Prill 1985, lindur në Sarandë dhe banues në Sarandë, mbajtës i letërnjoftimit No.037290516 dhe numër personal I50418141T me datë lëshimi 26/05/2021

ne zbatim të Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” ,

#### **Neni 1**

Vendosem të themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**M&G GROUP**” shpk.

#### **Neni 2**

Ortakt themelues të shoqërisë janë: z.Ferdinand ISMAILI, z.Pandeli DHIMA dhe z.Endrin LLANAJ.

#### **Neni 3**

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË**

- Investitor në fushën e ndërtimit
- Agjensi imobiliare

Shoqëria mund të ushtroje çdo veprimtari tjetër tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohej me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”).

#### **Neni 4**

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të organeve drejtuese të kësaj shoqërie.

#### **Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 10,000 lekë (dhjetëmijë) dhe përbëhet nga 3 (tre) kuota, e ndarë si më poshtë:

1. Ferdinand ISMAILI, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 3,334 (tremijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë, ose 33.34% të kapitalit themeltar

2. Pandeli DHIMA, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 3,333 (tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë, ose 33.33% të kapitalit themeltar
3. Endrin LLANAJ, kontribuon me 1 (një) kuotë prej 3,333 (tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë, ose 33.33% të kapitalit themeltar

#### **Neni 6**

Selia e shoqërisë është Lagja 3, Rruga “Onhezmi” Nr.20, Sarandë 9701.

#### **Neni 7**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar në kohë dhe fillon që nga momenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### **Neni 8**

Administrator i shoqërisë do të jetë z. Ferdinand ISMAILI, i cili do të qëndrojë në këtë detyrë për 5 vite, me të drejtë rizgjedhje dhe është i ngarkuar të kryejë akte dhe të marrë angazhime që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

#### **Neni 9**

Personaliteti juridik i shoqërisë fitohet me regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aktiviteti i saj do të fillojë pas kryerjes së procedurave ligjore. Në aktivitetin e shoqërisë do të përmbahemi statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj legjislacionin në fuqi. Kjo kontratë themelimi u redaktua në katër kopje, me vlerë të njejtë ligjore, një kopje dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, një kopje dorëzohet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë dhe nga një kopje ortakëve themelues të shoqërisë.

#### **ORTAKËT E SHOQËRISË “M&G GROUP” SH.P.K.**

**Ferdinand ISMAILI** \_\_\_\_\_

**Pandeli DHIMA** \_\_\_\_\_

**Endrin LLANAJ** \_\_\_\_\_